

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Këshilli Gjyqësor i Kosovës**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **328-26-5743-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Servisimi dhe Mirëmbajtja e Ashensorëve ne Objektet e Gjykatave dhe SKGJK-se**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	EALGA SH.P.K.
NUI	811862706
Adresa	Bulevardi Bill Klinton, BB 5/8 Hyrja D Nr.34
Vendi	Prishtinë,
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	044296833
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Ajshe Shala
Adresa elektronike	ealga.ks@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	07.08.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Servisimi dhe Mirëmbajtja e Ashensorëve ne Objektet e Gjykatave dhe SKGjK-se
Ankese

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Në bazë të tenderit të publikuar: Servisimi dhe Mirëmbajtja e Ashensorëve ne Objektet e Gjykatave dhe SKGjK-se me NRP: 328-26-5743-2-2-1, në afatin e rregullt kohor parashtrojmë kërkesë për rishqyrtim:

22.07.2026 – Njoftim për Kontrate

23.07.2026 – Kërkesa për Sqarime bazuar në Legjislaturën Aktuale

31.07.2026 – Kërkesa për Sqarime bazuar në Interpretimin e MINT

03.08.2026 – Kërkesa për Rishqyrtim të Njoftimit për Kontrate

06.08.2026 – Refuzimi i Kërkesës për Rishqyrtim të Njoftimit për Kontrate

10.08.2026 – Ankese në OSHP

17.08.2026 – Afati për dorëzimin e ofertave/kërkesës për pjesëmarrje

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK me rastin e zbatimit të aktiviteti të prokurimit me titull: **Servisimi dhe Mirëmbajtja e Ashensorëve në Objektet e Gjykatave dhe SKGJK-se me NRP: 328-26-5743-2-2-1** nuk ka respektuar dispozitat Ligjit për Prokurim Publik nr. Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068, Nr. 05/L-092, dhe Udhëzuesin Operative dhe Rregulloret e Prokurimit si ne vijim:

Neni 28 të LPP-së

Neni 59 të LPP-së

Neni 40 të RRPP 002/2024

Neni 7 të LPP-së

Gjithashtu në dosjen e tenderit nuk është rrespektuar baza kryesore ligjore e inspektimit periodik të ashensorëve në Republikën e Kosovës, që është rregullorja e RKS/MTI-së Nr. 05/2018, e cila rregullon sigurinë e ashensorëve në përdorim.

Përmes kësaj ankese, EALGA Sh.p.k., në cilësinë e trupës inspektuese të licensuar nga RKS/MTI, paraqet ankesë lidhur me dosjen e tenderit për aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.

Kjo ankesë bazohet në nenin 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar me ligjet Nr. 04/L-237, Nr. 05/L-068 dhe Nr. 05/L-092.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendimi 1:

Ne këtë ankesë e kemi bazuar në bazën kryesore ligjore të inspektimit periodik të ashensorëve në Republikën e Kosovës rregulloren e RKS/MTI-së Nr. 05/2018 për sigurinë e ashensorëve në përdorim.

Rregullorja 05/2018 e **shfuqizon** rregulloren 09/2012 të cilën AK e kishte përmendur në dosjen e tenderit.

Në përshkrimin e çmimeve të këtij tenderi pas kërkesës tonë për sqarim të datës 23.07.2026 e përgjigjur me 24.07.2026, AK ka përmirësuar nga 09/2012 në 05/2018.

Mirëpo në dosjen e tenderit ishte ende gabim e shkruar rregullorja 09/2012 dhe duhej të përmirësohet.

AK është pajtuar me këtë pretendim ankimor në shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 06.08.2026. Andaj me 06.08.2026 ka përmirësuar edhe në dosjen e tenderit i referohet korrekt rregullore më të re për sigurinë e ashensorëve në përdorim RKS/MINT 05/2018.

Ne po e vendosim këtë pretendim në ankesën tonë vetëm që PA të jetë i informuar që kemi pasur edhe këtë pretendim ankimor. Konsiderojmë që problematika e këtij pretendimi ankimor tanimë është sqaruar nga AK dhe ftojme PA që ti shqyrtojë më poshtë pretendimet tjera tona 2, 3 dhe 4. Me të cilat AK nuk është pajtuar në përgjigjjen e kërkesës për rishqyrtim dhe për të cilat ne si palë ankuese i jemi drejtuar OSHP.

Pretendimi 2:

Përmes kësaj ankese, synojmë të sqarojmë **joligjshmërinë** e delegimit të çështjes së inspektimit periodik te kompania mirëmbajtëse e ashensorëve. Ne këtë ankesë e kemi bazuar në bazën kryesore ligjore të inspektimit periodik të ashensorëve në Republikën e Kosovës rregulloren e RKS/MTI-së Nr. 05/2018.

Në listën e çmimeve të këtij tenderi, AK ka kërkuar që OE të paraqesë edhe çmimin për inspektimin periodik të ashensorëve. Rrjedhimisht, kjo lë të kuptohet se inspektimi periodik i ashensorëve synohet t'i delegohet OE-së mirëmbajtëse përmes këtij tenderi.

TABELA 2 Tabela - II –Niveli II- PESHIMI: 40 %		Njësia	Sasia	Çmimi për njësi me TVSH €	Titulli i prodhuesit	Vendi i Origjines
1	Mirëmbajtja e rregullt mujore sipas rregullores MTI Nr.05/2018 e cila nënkupton të gjitha veprimet e nevojshme sipas përkufizimit në nenin 3 të kësaj Rregullore.	copë	1			
2	Inspektimi periodik i ashensori çdo 12 muaj nga Trupat e autorizuar për vlerësimin e konformitetit sipas Rregullores Nr. 05/2018	copë	1			
3	Puna elektrike dhe mekanike pa pjesë norrimi	copë	1			
Totali me të gjitha taksat						

Prandaj, OE-ja mirëmbajtëse, respektivisht fituesi i këtij tenderi, do të jetë përgjegjës për organizimin e inspektimit vjetor të ashensorëve nga trupa inspektues të emëruar. Kjo përfshin **zgjedhjen** e kompanisë së licencuar që do të kryejë kontrollin e ashensorëve, si dhe mbulimin e pagesës për këtë shërbim.

Përmes dosjes së tenderit, më saktësisht pjesa e specifikimeve teknike të detyrueshme në tabelën 2 pika 2 në faqen 24 të dosjes së tenderit, kërkohet që operatori ekonomik të japi çmimin pra rrjedhimisht të angazhojë trupin inspektues. Ne vlerësojmë se kjo kërkesë **nuk** është në përputhje me legjislacionin në fuqi. Do të ishte ligjore që inspektimi i ashensorëve të realizohej përmes një **procedure të veçantë tenderuese ose përmes lot të veçantë**.

Përveq harmonisë ligjore, përmes tenderit ose lot të veçantë do tu mundësohej ndër tjera trupave inspektues edhe konkurrencë e drejtë vetëm për veprimtarinë e tyre pa pasur nevojë të hyjnë në matematika e pazare me kompanitë mirëmbajtëse për të qenë e përzgjedhura e tyre për inspektim.

Neni 3 Obligimet e pronarit <u>2. Pronari është i detyruar:</u> 2.1. <u>të sigurojë inspektimet e rregullta dhe inspektimet e jashtëzakonshme të nevojshme të ashensorëve;</u> 2.2. të nënshkruajë kontratë për mirëmbajtjen e ashensorit me një operator ekonomik kompetent për mirëmbajtje (në tekstin e mëtejshëm-Mirëmbajtësi), i cili i përmbush kërkesat e përcaktuara me këtë Rregullore;	INSPEKTIMIT, TRUPI I EMËRUAR PËR VLERËSIM TE KONFORMITETIT Neni 9 Inspektimi periodik i ashensorit 1. <u>Pronari siguron inspektimin periodik të ashensorit. Inspektimi periodik kryhet të paktën një herë në vit.</u> 2. Ashensorët duhet të inspektohen rregullisht nga trupi i emëruar për vlerësimin e konformitetit. <u>Pronari zgjedh një trup të emëruar nga lista e trupave të emëruara për inspektim periodik të ashensorëve.</u> 3. <u>Mirëmbajtësi i ashensorit merr pjesë në inspektimin periodik.</u> Nëse personi që ka kryer mirëmbajtjen nuk është kompetent ose i përgatitur për të bashkëpunuar në kryerjen e inspektimit periodik, trupi i emëruar mund të ndërpresë kryerjen e inspektimit dhe të njoftojë me shkrim për këtë inspektoratin kompetent, mirëmbajtësin dhe pronarin e ashensorit.
--	---

Më konkretisht siq shihet më lartë, Rregullorja e RKS/MTI-së Nr. 05/2018, e cila rregullon sigurinë e ashensorëve në përdorim, e obligon pronarin e ashensorit që ta angazhojë Trupin inspektues. Kjo saktësohet në nenin 3, “Obligimet e pronarit”, ku në pikën 2 dhe nën pikën 2.1 theksohet se pronari është i **detyruar** të sigurojë Trupin inspektues. E njëjta konfirmohet edhe në nenin 9, pika 1, ndërsa në nenin 9, pika 2 qartësohet se **pronari e zgjedh** Trupin inspektues që do të kryejë Inspektimin periodik të ashensorit.

Neni 6
Përgjegjësia e mirëmbajtjesit të ashensorit


1. Mirëmbajtjesi i ashensorit obligohet të:

1.1. kryej mirëmbajtjen në përputhje me

1.6. evidentoj rezultatet e inspektimeve të rregullta dhe çfarëdo intervenimi në ashensor;

1.10. siguroj që personi që ka kryer mirëmbajtjen të jetë i pranishëm në inspektimet periodike dhe të jashtëzakonshme.

Më tej siq shihet më lartë, neni 6 i kësaj rregulloreje përcakton përgjegjësitë e mirëmbajtjesit. Sa i përket inspektimit të ashensorëve, mirëmbajtësi obligohet të evidentojë rezultatet e inspektimeve (pika 1.6) dhe të jetë i pranishëm gjatë inspektimit (pika 1.10). Pra, legjislacioni në fuqi me asnjë dispozitë ligjore **nuk** e autorizon mirëmbajtësin të caktojë Trupin inspektues. Kjo konfirmohet edhe në nenin 9, pika 3, ku theksohet se mirëmbajtësi duhet **vetëm** të jetë i pranishëm gjatë inspektimit.



Prandaj, kërkesa për pjesëmarrje në këtë tender, tabela 2 pika 2 në faqen 24, është në kundërshtim me Rregulloren RKS/MTI Nr. 05/2018 për sigurinë e ashensorëve në përdorim, konkretisht me nenin 3 pika 2 dhe 2.1, nenin 6 pika 1.6 dhe 1.10, si dhe nenin 9 pika 1, 2 dhe 3.

Gjithashtu duam ta njoftojmë PA se shumica e institucioneve, si Ministria e Punëve të Brendshme (për ashensorët e objekteve qeveritare), Këshilli Prokurorial i Kosovës, KEK-u, Zyra Kombëtare e Auditimit, Universiteti i Mitrovicës dhe institucione të tjera, duke respektuar procedurën **ligjore** në përputhje me **obligimet** e Rregullores RKS/MINT Nr. 05/2018, zhvillojnë procedura **të veçanta** të prokurimit vetëm për inspektimin periodik të ashensorëve, duke kontraktuar drejtpërdrejt trupat inspektuese me tender vetëm për këtë qështje.

Andaj përmes kësaj ankese kërkojmë që inspektimi periodik i ashensorëve të hiqet nga dosja e tenderit dhe inspektimi i ashensorëve të realizohet me tender të veçantë ose lot të veçantë **konform** legjislaturës së lartpërmendur. Kjo i mundëson **konform** legjislaturës në fuqi pronarit të **zgjedhë drejtpërdrejtë** trupin inspektues.


Pretendimi 3:

Përmes dosjes së tenderit, më saktësisht pjesa e specifikimeve teknike të detyrueshme në tabelën 2 pika 2 në faqen 24 të dosjes së tenderit, kërkohet që operatori ekonomik të japi

çmimin pra rrjedhimisht të angazhojë trupin inspektues për inspektimin vjetor të ashensorëve. Përmes kësaj kërkesë të **jashtëligjshme**, kompanisë mirëmbajtëse i jepet **jashtëligjshëm** edhe e drejta që ta **zgjedhë** se cili trup inspektues nga lista e trupave të emëruar nga MINT të bëjë inspektimin periodik të ashensorëve.

INSPEKTIMIT, TRUPI I EMËRUAR PËR VLERËSIM TE KONFORMITETIT
Neni 9 Inspektimi periodik i ashensorit
1. Pronari siguron inspektimin periodik të ashensorit. <u>Inspektimi periodik kryhet të paktën një herë në vit.</u>
2. Ashensorët duhet të inspektohen rregullisht nga trupi i emëruar për vlerësimin e konformitetit. <u>Pronari zgjedh një trup të emëruar nga lista e trupave të emëruara për inspektim periodik të ashensorëve.</u>
3. <u>Mirëmbajtësi i ashensorit merr pjesë në inspektimin periodik.</u> Nëse personi që ka kryer mirëmbajtjen nuk është kompetent ose

Ky veprim bie ndesh me nenin 9 pika 2 të rregullores RKS/MINT 05/2018. Përmes dosjes aktuale të tenderit, AK si pronar i ashensorit i **pamundësohet** zbatimi i nenit 9, pika 2 të Rregullores RKS/MINT Nr. 05/2018. Si do ta zgjedhë AK sipas obligimit ligjor trupën inspektuese nga lista e trupave të emëruar, nëse këtë kompetencë **jashtëligjshëm** ia delegon mirëmbajtësit? Cili nen apo cila pikë e Rregullores RKS/MINT Nr. 05/2018 e lejon delegimin e zgjedhjes së trupës inspektuese te mirëmbajtësi?



Për rrjedhojë, kërkojmë nga PA që, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ta obligon AK që ta largon shërbimin e inspektimit periodik të ashensorëve nga dosja e këtij tenderi. Trupa inspektuese duhet të përzgjidhet në përputhje me ligjin **vetëm** nga pronari, përmes një procedure të veçantë të prokurimit ose, së paku, përmes një loti të veçantë, në mënyrë që pronarit ti mundësohet zgjedhja e **drejtpërdrejtë** e trupës inspektuese, ashtu siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Pretendimi 4:

Lidhur me çështjen e inspektimit periodik të ashensorëve në përdorim, ju njoftojmë se EALGA Sh.p.k., në cilësinë e trupës inspektuese **të akredituar dhe të emëruar** nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) për kryerjen e inspektimeve periodike të ashensorëve, ka kërkuar interpretim zyrtar edhe nga Departamenti i Industrisë në MINT.

Përgjigjja zyrtare e MINT-it **konfirmon** edhe një herë interpretimin tonë se Rregullorja RKS/MINT Nr. 05/2018 e **obligon** pronarin e ashensorit që ta **zgjedhë drejtpërdrejt** trupën inspektuese nga lista e trupave të emëruar nga MINT. Siç është **konfirmuar** edhe nga vetë MINT-i, asnjë dispozitë e kësaj rregulloreje **nuk** i jep të drejtë pronarit që këtë kompetencë ta delegojë te mirëmbajtësi i ashensorit. Për referencë, në fund të këtij dokumenti gjeni përgjigjen zyrtar të MINT-it.



Edhe një herë kërkojmë që PA ta obligojë AK ta zbatojë legjislacionin në fuqi për inspektimin periodik të ashensorëve në përdorim. Në përputhje me këtë legjislacion, AK në cilësinë e pronarit të ashensorit, **obligohet** që ta zgjedhë **vetë** trupën inspektuese nga

lista e trupave të emëruar, sipas nenit 9, pika 2 të Rregullores RKS/MINT Nr. 05/2018. Asnjë dispozitë e kësaj rregulloreje **nuk** parashikon dhe **nuk** lejon që kjo zgjedhje ti delegohet mirëmbajtësit, siç është paraparë në dosjen e këtij tenderi.

Për rrjedhojë, kërkojmë nga PA që ta obligojë AK që, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ta largon shërbimin e inspektimit periodik të ashensorëve nga dosja e këtij tenderi. Trupa inspektuese duhet të përzgjidhet në përputhje me ligjin **vetëm** nga pronari, përmes një procedure të veçantë të prokurimit ose, së paku, përmes një loti të veçantë, në mënyrë që pronarit ti mundësohet zgjedhja e **drejtpërdrejtë** e trupës inspektuese, ashtu siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Perfundim:

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartpërmendura, kërkojmë nga PA-ja që:

Ta shpallë ankesën tonë të bazuar dhe të urdhërojë AK që dosja e tenderit të përmirësohet, ashtuqë inspektimi periodik i ashensorëve të hiqet nga dosja e tenderit dhe inspektimi i ashensorëve të realizohet me tender të veçantë ose lot të veçantë konform legjislaturës së lartpërmendur.

Shpresojmë që kërkesat tona do të trajtohen me kujdes, në mënyrë që inspektimi periodik i ashensorëve të realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kjo i mundëson pronarit të zgjedhë trupin inspektues konform legjislaturës në fuqi.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demet e shkaktuara janë shpenzimet ne përgatitjen e ofertës, dëme ne reputacion dhe fitimi i humbur.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*